



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 05/2011
Prishtinë, më 15.04.2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostić.

Munguan: Fikrim Damka, Lutfi Zharku, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Të ftuarit për raportim: Përparim Kabashi dhe Ejup Hasolli- ZRRE.

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati- NDI, Sanije Berisha - OSCE dhe Lumnije Murati ZPRK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatori të Energjisë për vitin 2010;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatori të Energjisë për vitin 2010

Kryetari – e ftoi përfaqësuesin e Zyrës së Rregullatori të Energjisë që ta paraqesë Raportin vjetor për vitin 2010.

Përparim Kabashi, (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – theksoj se Zyra e rregullatorit e ka dërguar me kohë Raportin bazuar në Ligjin për rregullatorin e energjisë me nenin 9-të të saj me të cilin kërkohet që zyra e rregullatorit të përgadit raportin vjetor duke i përfshirë aktivitetet për energji, aktivitetet e zyrës si dhe aktivitetet të cilat zhvillohen në sektorin e energjisë në Kosovë. Raporti vjetor përbëhet prej nëntë kapitujve. Një vend i rëndësishëm në këtë raport i është kushtuar edhe raportit financiar d.m.th të hyrat e zyrës së rregullatorit, të hyrat e përcaktuara sipas buxhetit të Republikës së Kosovës shpenzimet sipas kategorive buxhetore. Është një raport i detajuar për të gjitha shpenzimet e ZRRE-së për punën gjatë vitit 2010. Nga ana e Zyrës së rregullatorit është përgatitur raporti konsultativ është dhënë në diskutim është komentuar, pas vërejtjeve të dhëna Zyra e rregullatorit në maj të vitit 2010. Bordi i Zyrës së rregullatorit ka marrë vendim për tarifat për të cilat nuk ka pasur ndryshim të tarifave me energjinë elektrike. Gjatë këtij viti janë zgjedhë 220 kërkesa, në vitet paraprake Zyra e rregullatorit ka pasur kërkesa të shumta nga ana e konsumatorëve të cilët kanë të bëjnë kryesisht me keqpërdorimin e energjisë elektrike. Mirëpo tani konsiderojmë sipas ndryshimit të ligjit për energjinë elektrike, ku keqpërdorimi i energjisë elektrike trajtohet si vepër penale besoj që këto raste nuk do të dorëzohen në Zyrën e rregullatorit për zgjidhje sepse do të merren gjykatat me këto raste. Është paraqitur perspektiva e zhvillimit ekonomik të gasi natyror në Kosovë, ku ne në Kosovë nuk kemi gas është një trase e vjetër e gypave të vjetruar që janë vendos. Mirëpo është informuar në përgjithësi për aktivitetet regjionale që bëhen sa i përket gasit. Kosova gjendet në një pozitë mirë që në të ardhmen të furnizohet me gas. Aktivitete ndërkombëtare të Zyrës së rregullatorit është anëtare e Komunitetit të energjisë për Evropën lindore, i ka përfaqësuesit e saj në katër grupet punuese, dhe jep kontributin e vet atje. Është angazhuar që projektet e veta prej këtij komuniteti si në aspektin rregullativ i çështjes që ka të bëjë me rregullatorin e energjisë që të trajtohen si duhet dhe ta kenë vendin e merituar.

Kryetari - Bordi i ZRRE-së më 30 Prill 2010 ka marrë vendim, që në periudhën kohore prill-tetor 2010, të licencuarit të lirohen nga detyrimi i pagesës së taksës vjetore për shërbimet e ZRE-së (faqe 11 të raportit). Mbi çfarë baze ligjore Bordi i ZRE-së ka marrë këtë vendim?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – vendimi ka bazë ligjore edhe bazuar në ligjin për rregullatorin të energjisë. Të hyrat janë nga Zyra e rregullatorit që të importohet për arsye se është grumbulluar një sasi e madhe e mjeteve më e madhe, se sa Zyra e rregullatorit ka mundur ta shpenzoj për buxhetin që është paraparë dhe kjo ka qenë një vendim i Bordit. Është pritur që të grumbullohen më shumë mjete për këtë arsye është marr ky vendim nga ana e bordit .

Ejup Hasolli (Përfaqësues i ZRRE-së) - Zyra e rregullatorit për energji financohet nga të hyrat që i inkason nga të licencuarit ose për çdo Megavat orë energji e prodhuar 22 cent e energjisë së importuar. Sipas kësaj është konsideruar kur është vendosur pasqyra e taksave që kjo duhet të jetë tarifa e cila do të mbledhet nga të licencuarit .Mirëpo si duket është një tarife pak më e lartë

se sa nevojat e ZRRE-së kështu që duke marr parasysh edhe të hyrat e bartura të pa shpenzuara nga viti i kaluar të viti 2009-të që janë bartur në këtë vit.

Hashim Deshishku - me çfarë kriteri ju bazoheni si Bord për me i liruar ato taksa? A ka ndonjë kriter të veçantë apo edhe kush lirohet? Sepse janë në pyetje 676 mijë euro.

Kryetari – A është një nen i veçantë apo dispozitë e caktuar në ligj i cili ju mundëson një gjë të tillë?

Ejup Hasolli (Përfaqësues i ZRRE-së) - këto 676 sa mijë euro që janë të prezantuara në Raport, janë mjete të cilat në bazë të shqyrtimit tarifar për çmimin e energjisë elektrike për vitin e ardhshëm merren parasysh nga Zyra e rregullatorit. Edhe futen në çmimin kushtues ose në shpenzimet e të licensuarve të cilat minusohen d.m.th kur vjen aplikacioni ne tarifat për rregullatorin nga kompanitë në këtë rast nga KEK-u.

Berat Buzhala - a keni të drejt ju që sa herë të doni me i qit edhe me hjek këtë taksë? Sepse këtu e keni shkruar që e keni marr afatin për me eliminuar këtë takse. Në bazë të çfarë neni a ligji? Çfarë mandati keni ju me hjek edhe me qit sa herë doni këtë taksë?.

Ejup Hasolli (Përfaqësues i ZRRE-së) - në ligjin e Rregullatorit për energjinë edhe në ligjin mbi financimin e financave publike, të hyrat e Zyrës së rregullatorit janë të hyra të dedikuara që do të thotë janë të dedikuara për rregullatorin.

Myzejene Selmani – theksoj se materiali që është sjellë ne Kuvend është shumë më i mirë se sa prezantimi gojor që bëri përfaqësuesi i ZRRE-së.

Hashim Deshishku - pyeti se cila është arsyeja e juaj për këtë lirim? A ka pasur kritere edhe a ka pasur kritere për lirimin? Apo të licencuarit a kanë qenë në ndonjë situatë financiare të keqe që ju i keni liruar?

Ejup Hasolli (Përfaqësues i ZRRE-së) - buxheti i Zyrës së rregullatorit vendoset nga komisionin e buxhetit dhe Parlamenti i Kosovës për vitin 2010. Ky buxhet ka qenë fillimisht 930 mijë euro do të thotë në të hyrat e dedikuara për Zyrën e rregullatorit për energji. Sipas ligjit të buxhetit 2010 edhe për tash për buxhetin e vitit 2011 janë ty hyrat e dedikuara ato të cilat janë të parapara në buxhet dhe çdo shumë që del mbi atë mbi buxhetin e aprovuar nga Kuvendi d.m.th nuk janë të hyra të zyrës së rregullatorit. Ligji mbi zyrën e rregullatorit edhe Ligji mbi menaxhimin e financave publike edhe përgjegjësitë nuk e obligon Zyrën e rregullatorit të energjisë të mbledh taksa për Zyrën e rregullatorit .

Hashim Deshishku - në tabelën në faqen 14-të, ku mundet me qenë edhe gabim teknik në tabelën 2.10 keni të hyrat e bartura të vitit 2010, e jo të vitit 2009-të, kurse 2010 keni tjetër shifër që do të thotë se çdo vit jeni duke i bartur por prapë nuk po mundeni me i shpenzuar.

Kryetari - theksoj se Zyra e rregullatorit ka lëshuar njoftim autorizim preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja nga burimet e ripërtrishme të energjisë edhe deri më tani është lëshuar vetëm një autorizim. A keni mbajtur ju ndonjë aktivitet si ZRRE për senzibilizim të investitorëve të mundshëm me i tërheq këta investitorë?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – theksoj se në Raport është e kompletuar korniza rregullative nga burimet e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet e ripërtrishme nga importet dhe eksportet.

Berat Buzhala – pyeti se a do jeni ju avokat i korporatës në këtë rast? Sepse është e pa mundshme 11-të vite mos me ditë se kur importohet dhe kur eksportohet më shumë. Me ble megavatin për 70 euro e me shit për 20 euro, pra si është e mundur një korporatë mos me pas një plan. Mos me pas parasysh në fillim të vitit paraprak se në cilin kohë blejmë më shumë e në cilën kohë shesim më shumë. Kuptohet ne blejmë në dimër e shesim kryesisht gjatë muajve të pranverës ose të vjeshtës, sepse gjatë verës blloqet shkojnë në remont. Pra a ju ka shtruar dikush këto pyetje? Sepse këto ju i keni të obligueshme kur kërkohet me ligj që korporata e energjisë elektrike KEK-u edhe të gjithë operatorët tjerë me ju nënshtruar efikasitetit edhe transparencës së realizimit në projektet e tyre. Pra cili është komunikimi i juaj me korporatën?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – sipas përvojës sonë ne i prezantojmë të gjitha aktivitetet të licencuarëve. E paraqita vetëm atë se çka ka ndodh dhe nuk potencova se është ky çmim i volitshëm ose ai. Sepse është përgjegjësi. Ne nuk jemi përgjegjës për menaxhimin në të licencuar por realisht që kjo hynë në ato kur mund të sigurohet energjia më e volitshme se si duhet të bëhet planifikimi. Sepse gjithmonë ekzistojnë mundësitë, mirëpo është edhe një element tjetër të cilin konsideroj ndryshimet e aspektit të importit ka ndryshime të mëdha, brenda afateve të caktuara nganjëherë nëse merret dy muaj përpara merret çmimi më i volitshëm apo një muaj prapa. Është çështja edhe kriza e përgjithshme globale që është në përgjithësi. Ne jemi në komunikim të vazhdueshëm me KEK-un. Por rekomandime të këtij lloji nuk kemi në kuadër të përgjithshëm të rregullatorit por ne jemi për monitorimin e kontratave të cilat i ka siguruar KEK-u. Importet janë në rregull sipas procedurave të cilat ndikojnë. Mirëpo në nuk kemi kapacitete ta orientojmë KEK-un lidhur me marrjen e energjisë. Mirëpo është pjesë e biznesit të KEK-ut.

Kryetari – theksoj se te puna e mekanizmit për llogaritjen e kompensimit tranzit, ku në regjion Kosova nuk është paraqitur në këtë mekanizëm dhe si rezultat te ne ka humbje që të cilin e paguan konsumatori. A janë llogarit sa është kjo humbje si pasoj që ne sjemi pjesë e këtij mekanizmi?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – çështja e tranzitit të llogarisë elektrike është paraqitur gjithashtu edhe në këtë Raport sikurse edhe në raportet e tjera të viteve të kaluara të cilat mundohemi që ta mbajmë sistemi në koreale ku ende nuk mundet u zhvilluar për shkak të problemit me Serbinë. Ky kontest që është hap ne Komunitetin e energjisë janë mbajtur takime edhe ne Bruksel. Si kontekst d.m.th është kontesti i tranzitit edhe kontesti i shërbimit sekondar .

Berat Buzhala - pyetje lidhur me kompaninë serbe ALPISCH nga Beogradi, me të cilën kontrata është vazhduar edhe për vitin 2011-të. Sepse në disa faqe më poshtë në Raportin e juaj shkruan si rrjedhoje e humbjeve të shkaktuar dhe pengesat të cilat janë bërë nga Serbia dhe si është e mundshme të licencohen një kompani nga Serbia?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – realisht këto janë dy probleme të ndryshme, këta marrin licencë për tregti të energjisë elektrike kryesisht për importin që realizon KEK-u, jo për tranzitin e kompanitë të cilat janë të licencuara prej Zyrës së rregullatorit janë për tregti ku shënon aty për tregti që e shfrytëzon KEK-u për nevojat e veta. ndërsa kompanitë të cilat e tranzistojnë energjinë elektrike përmes linjave tona 400 KiloVolteshe ato nuk kanë licencë nga Zyra e rregullatorit. Sepse menaxhimin e kapaciteteve e bënë Serbia ata e bëjnë elaukimin e kapaciteteve ku në një mënyrë ata prej neve nuk kanë licencë. Firma ALPISCH e ka pasur licencën ju ka vazhduar edhe për ja dy vite për import që e siguron KEK-u të gjitha kompanit të cilat kanë energji elektrike licencohen nga Zyra e rregullatorit e jo që kalojnë në transit.

Berat Buzhala – kërkoj vëmendje të Ligji dhe tek politikat jo diskriminuese, Zyra e rregullatorit e ka aprovuar planin A, B ,C, konstatoi se ky është një diskriminim i pastër. Si pra është e

mundshme me u aprovuar ky plan kur ju e dini mirë se konsumatorët në mënyrë pafajshme janë viktime e atyre të cilët nuk e paguan rrymën.

Kryetari - ka edhe disa ankesa te tjera të qytetarëve në adrese të KEK-ut të cilët nuk kanë të bëjnë me planin ABC edhe ju i dini ato. A ka rregullatori masa të caktuara edhe në kuadër të kompetencave tuja të fushëveprimit në këtë drejtim?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – Shkyçjet kolektive janë të ndaluara edhe për legjislacionin primar në mënyrë strikte janë të përcaktuara me shkyçje dhe rishkyçje pra nuk janë të lejuara. Mirëpo skema ABC ka mbetur ende në praktik është analizuar disa herë. Këtu janë dy mundësi e para që të hiqet skema ABC mirëpo prapë do të ketë reduktime.

Berat Buzhala – pyeti se a është kjo diskriminuese kjo?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – në një mënyrë po ndërsa në mënyrën tjetër jo sepse është prej këndvështrimit se si e vështrojnë nëse një grup i konsumatorëve jo 100 % e bëjnë pagesën të energjisë elektrike.

Kryetari – theksoj se shpesh djegëja e shtëpive konstatohet si pasojë e rrymës elektrike a ka pasur ankesa të tilla dhe çka mendoni për të ju si rregullator?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – jo ne nuk kemi pasur ankesa raste te tilla. Kemi pasur informacione për raste te tilla që kanë ndodh mirëpo për këto raste merret gjykata sepse krijohen grupe ekspertësh sepse duhet të përcaktohet në mënyrë profesionale se a ka qenë me të vërtet energjia elektrike shkaktare apo jo.

Hashim Deshishku - pyeti se sa punëtorë i ka zyra e rregullatorit të energjisë elektrike?

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – Zyra e rregullatorit të energjisë elektrike i ka në skemë 33 punëtorë mirëpo 27 jemi për momentin.

Hashim Deshishku – pyeti se çka shpenzon KEK-u më shumë për shpenzimin e energjisë, thënxhillin, karburantin apo mazutin? A është kjo kjo kompetencë e Zyrës së rregullatorit që ta dije sepse kjo në raport nuk cekët? Po ashtu kërkoj sqarim rreth eksportit dhe importit të energjisë elektrike.

Përparim Kabashi (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – në Zyrën e rregullatorit paraqiten shpenzimet operative të mirëmbajtjes dhe kapitalit të sipas të licencuarve duke filluar prej gjenerimeve. Sepse Zyra e rregullatorit e ka përgjegjësinë duke filluar prej gjenerimeve e më poshtë. Çështja e importit dhe eksportit ndërlihet me një aspekt tjetër. Importi është kur një kompani është në gjendje me e gjete çmimin më të volitshëm për me i furnizuar konsumatorët e vet edhe kur mundet energjinë që e krijon me e dërgua dallimi është vetëm për këtë sepse Kosovës i nevojitet për import kur nevojat janë shumë më të mëdha .

Sala Berisha- Shala - rreth ankesave të konsumatorëve e që nuk që kanë qenë kundër vendimeve të cilat i ka lëshuar KEK-u. Por ne jemi dëshmitarë të asaj që ne shpesh i shohim nëpër media se qytetarët ankohen për fatura të fryra sidomos në fund të viteve. Ne në këtë drejtim se çka ka bërë Zyra e rregullatorit të energjisë përkatësisht divizioni për mbrojtjen e konsumatorit? Keni një numër të ankesave në vite dhe shihet në raport se sa prej ankesave janë shqyrtuar, është e pa përballueshme një ngarkesë e tillë se këtu janë të evidentuara 190 konsumatorë shtëpiak, 78 prej tyre edhe konsumator komercial etj. Ndërsa pyetja tjetër është që plot projekti për njësoret digjital, a keni ndonjë ankesë për njësoret digjital? Sepse në jetën

private dëgjoj se këta njehsorë digjital e bëjnë një kapërcim të jashtëzakonshëm të regjistrimit të tarifave.

Përparim Kabashi, (Anëtar i Bordit i ZRRE - së) – kemi pasur ankesa telefonike mirëpo nuk kemi pasur ankesa të regjistruara. Zyra e rregullatorit të energjisë elektrike merret me ankesa të konsumatorëve në rast se konsumatori bënë ankesë zyrtare. Sepse konsumatorët janë të obliguar në mënyrë ligjore të bëjë ankesë zyrtare nga i licencuari, nëse i licencuari i kthen përgjigje negative ose nuk e zgjedh problemin e konsumatorit. Konsumatori ka të drejtë të ankohet në Zyrën e rregullatorit të energjisë elektrike. Instituti i metrologjisë që ka qenë në Prizren dmth qendra e kalibrimit në KEK mirëpo atje është një problem të cilin ne e kemi kërkuar edhe në bisedime me KEK-un që qendra e kalibrimit duhet të jetë si institucion jashtë KEK-ut.

Pas debatit të gjerë Komisioni unanimit nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë- ZRRE-së për vitin 2010

dhe Kuvendit i parashtroi këtë:

Rekomandim

- 1. Të miratohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ZRRE-së për vitin 2010.*
- 2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, kryetari i Komisionit Zenun Pajaziti.*

3. Të ndryshme;

Kryetari – propozoj që mbledhja e radhës të mbahet më 19.04.2011 më këto pika të rendit të ditës: Shqyrtimi në parim i Projektligjeve nr.04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-069 për Akreditim; Projektligjit nr.04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë tregtare; Projektligjit nr.04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e brendshme dhe të shqyrtohet Raporti Vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010;

Propozimi përkrah unanimit nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti
Kryetar i Komisionit